

**28.05.2021  
Ora 11:07**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr.53, datë 09.05.2021 të subjektit ankues Koalicionit Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim PD-AN, për zonën zgjedhore Qarku Lezhë"**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD-AN, LSI

**Z. K. Bele:** Deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin e ankimit nr. 53, të subjektit ankues kandidati i mbështetur nga zgjedhësit zotit Iljaz Shehu, me objekt kundërshtimi vendimi nr.349 datë 4.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Lezhë. Relator i kësaj seance jam unë Koli Bele sipas shortit të hedhur me datë 11.05.2021, relatojmë gjithashtu se gjatë gjithë kësaj periudhe KAS ka qenë duke ndjekur në mënyrë të përditshme çështjet e tjera. Verifikojmë paraprakisht legjitimitimin procedural të palëve, paraprakisht relatoi për KAS prezente është administrata e KQZ se nga ana e administratës na është vënë në dispozicion një mesazh komunikim me zotin Shehu, i dërguar dhe lidhur me komunikimin për këtë seancë. Mesazhin po e lexoj: “Përshëndetje zoti Shehu, nesër në orën 11:00 Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve do të shqyrtojë kërkesën ankimore të depozituar nga ana e juaj për Qarkun e Lezhës”. Përgjigja është e sotme mban orën

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

09:57 : “ Përshëndetje Olsi, faleminderit për mesazhin duke marrë parasysh mënyrën se si kanë vajtur gjërat, hedhja poshtë e provave edhe për qytetet e tjera kam vendosur të mos paraqitem tek komisioni i ankimeve dhe mos e ndjek ankesën për Qarkun e Lezhës. Gjithë të mirat, Iljaz Shehu”. Atëherë, nga pikëpamja e legjitimitetit a ka ndonjë kërkesë të depozituar për ndonjë subjekt për të qenë palë në proces.

**Z. Y. Merkaç:** Subjekti zgjedhor Partia Socialiste, ka paraqitur kërkesë për t’u futur si palë e interesuar në këtë procedurë administrative. Po edhe Partia Demokratike ka sjellë një kërkesë për t’u futur si palë e interesuar.

**Znj. U. Gjoshë, përfaqësuese e LSI:** Po jemi mbështetëse e kërkesës ankimore nga Partia Demokratike.

**Z. K. Bele:** Nga pikëpamja procedurale që të jeni pjesë aktive në këtë seancë do të duhet që të legjitimoheni dhe kjo bëhet duke deklaruar interesin tuaj për të qenë palë në proces. Ku mund të mbështesni secilën nga palët.

**Znj. U. Gjoshë, përfaqësuese e LSI:** Po patjetër jemi të interesuar.

**Z. K. Bele:** Pra, ju kërkoni të jeni palë dhe paraqesni. Sigurisht këta, zgjedhin të mbështesin zotin Iljaz sepse ai është ankues po thanë ne futemi si palë. Megjithatë këtu ka një moment procedural që ne do të duhet t’a diskutojmë nëse mund të çelet seanca edhe për efekt të legjitimitetit të palëve në kushtet kur ankuesi kryesor ka vendosur në lëvizje KAS-in me këtë ankim. Nuk ka treguar interes për të qenë palë. Nga komunikimi i cili është gjithashtu një formë e njohur e komunikimit, pra

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

komunikimi me personin e administratës. Në vlerësimin tim paraprakë rezulton se ankuesi është tërhequr nga interesi që ka për këtë çështje dhe në këtë kuptim jemi në kushtet e nenit 142 të kodit, i cili në këto raste parashikon pushimin e çështjes. Nuk e di kolegët nëse mund t'a diskutojmë këtu apo mund të tërhiqemi edhe në dhomë për t'a diskutuar.

**Z. L. Braho:** Edhe unë jam në të njëjtin mendim me ju zoti Bele, se po t'a analizojmë mesazhin i ka të dy komponentët. Kamë vendosur të mos paraqitem tek komisioni i ankimeve dhe të mos e ndjek ankesën. Pra, nëse qëllimi do ishte vetëm mosparaqitja që të zhvillohej seanca në mungesë do ishte lënë në këtë pjesë. Por përderisa ka përfshirë edhe pjesën që të mos e ndjek ankesën për Qarkun e Lezhës edhe për mendimin tim ka shprehur vullnetin për t'u tërhequr nga objekti i ankimit.

**Z. K. Bele:** Por edhe në përmbatje të tekstit pavarësisht se është çështje si e vlerëson ankuesi por tregon që në tërësinë e tij nuk ka, e ka humbur besimin tek ankimi përpara këtij organi përveçse ka shprehur vullnetin për t'u tërhequr. Nuk e di nëse kanë ndonjë gjë për të shtuar kolegët?

**Z. E. Çefa:** Thjesht për t'a plotësuar argumentin, unë po citoj pak edhe nenin 94 të Kodit të Procedurave Administrative. I cili bën fjalë për kërkesën për tërheqjen e kërkesës apo braktisjen e procedurës. Pika 4 e tij thotë: procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtarë për çështjen në qoftë se pala e interesuar për fajin e saj ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij kodi. Kështu që në këtë rast më tepër se sa heqje dorë. Unë do t'a kisha konsideruar braktisje të kërkesës dhe absolutisht edhe kjo sjell për pasojë pastaj të kësaj procedure pa një vendim për themelin.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

**Z. K. Bele:** Ju mund të shpreheni por ne po diskutjmë një moment procedural që në vlerësimin tim por pres t'a ndaj edhe me kolegët. Në vlerësimin tim momentin procedural që nuk vlerësojmë që ankesa qendron, pra ajo që e vendos në lëvizje komisionin. Në këtë moment unë nuk mendoj që KAS mund të legjetimoj palët e tjera për të qenë prezente proceduralisht në .. sigurisht që ju mund të flisni. Po nga pikëpamja e legjitimitetit tuaj të jeni në një proces i cili në vetvete nuk qendron më si proces. Mendoj që në këtë moment ne konstatojmë nëse kemi çështje administrative në procedim dhe pastaj ne duhet të shprehemi për legjitimitetin e palëve të interesuara për të vazhduar procesin. Të paktën ky është mendimi im,

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Pa mikrofon, nuk dëgjohet!**

**Z. K. Bele:** Dakord po nëse eventualisht, nuk po e diskutoj, po nëse eventualisht, palët do të donin të vazhdonin çështjen. Në situatën kauzistike a mund të vazhdojë çështja kur ankuesi nuk është më.

**Z. L. Braho:** Mund t'i referohemi edhe pikës 3 të nenit 133 që thotë që pranimiti i palës së interesuar në procedurën administrative bëhet me vendim të KQZ-së. Në fillim të seancës përkatëse dhe pas verifikimit të pjesëmarrësve të palëve të tjera. Kështu që duke qenë se nga verifikimi nuk na rezulton atëherë, mund të...

**Z. K. Bele:** Atëherë, KAS i konsultuar në vend, në mbështetje të nenit 143 të pika 1 shkronja a, në përfundim të konsultimit dhe shqyrtimit të ankimit në këtë fazë vendos pushimin e shqyrtimit të ankimit administrativ. Ky vendim shpallet sot, në orën 11:15, data 28. 05.2021. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda afatit 5 ditor në Kolegjin Administrativ. Faleminderit!

**Vendimi nr.92**

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 40, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD – AN, për zonën zgjedhore Qarku Elbasan”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Meta,
- **Parti Politike:** PS, LSI, PD

**Z. E. Lako:** Atëherë, vazhdojmë seancën publike të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve me ankimin, kërkesa ankimore nr. 40, të datës 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike Aleanca Për Ndryshim dhe palët e interesuara në proces Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste Për Integrim. Seancën e kaluar u dhamë kohë për të marrë provën e kërkuar nga 2 anëtarët e KAS për kryqëzimin e të dhënëve të pajisjes PEI. Në dijenin time kjo e dhënë është nxjerr dhe i është dhënë palëve, zoti Sekretar i Përgjithshëm?

**Z. Y. Merkaj:** Po i është vënë në dispozicion palëve.

**Z. E. Lako:** Po edhe Komisionit kështu që besoj jemi në kushtet ku ftojme ankuesin fillimisht.. për Elbasanin sepse e referova si numër. Kërkesa nr. 40 pra,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

për Elbasanin ftojmë palën ankuese nëse ka ndonjë koment mbi provën e kërkuar dhe të marrë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues i seancës. Jemi njohur dje me provën e kërkuar nga ana jonë, kryqëzimin e të dhënave të pajisjes PEI. Nga të cilat sipas informacionit rezulton që ka rreth 23 shenja gishtërinjsh që janë përdorur për identifikimin e 63 zgjedhësve pra, 63 mjeteve të identifikimit të ndryshme. E cila në vlerësimin tonë krijon dyshimin e arsyeshëm se 23 persona mund të kenë votuar 63 herë. Më shumë rreth kësaj prove besoj që do të kemi mundësi të relatojmë dhe në momentin e konkluzioneve tona përfundimtare, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Logu, nga palët e interesuara keni ndonjë koment mbi..?

**Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së:** Jo, nuk kemi.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** As me jo.

**Z. E. Lako:** Anëtarët e KAS-it kanë ndonjë pyetje ose ndonjë sqarim rreth kësaj prove të re? Nuk ka. Atëherë, pyesim edhe njëherë palët nëse kanë ndonjë provë tjetër në dobi të çështjes? Para se t'i japim fund hetimit administrativ.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ne nuk kemi kërkesa të tjera lidhur me marrje provash, faleminderit.


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

**Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së:** Nuk kemi I nderuar, faleminderit.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** As ne nuk kemi kërkesa të tjera.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, atëherë besoj se kemi ardhur në fund të procedurës. Dëgjojmë konkluzionet përfundimtare për ju fjala zoti Logu.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues i seancës konkluzionet tona i kemi me shkrim, janë 7 faqe dhe në 3 kopje të ndryshme. Nëse mund të afrohen për t'iuua vënë në dispozicion? Siç kemi pasur mundësinë të njihemi përgjatë këtij shqyrtimi administrativ që është bërë përpara Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, Partia Demokratike Aleanca Për Ndryshim ka paraqitur në datën 09 Maj 2021 një ankim duke kërkuar kundërshtimin e vendimit nr. 134, datë 04.05.2021 - Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore të Qarkut Elbasan dhe duke kërkuar njëkohësisht pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021 në zonën zgjedhore Qarku Elbasan dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në një periudhë sa më të afërt. Nga ana e Partis Demokratike të Shqipërisë në emër të Aleancës për Ndryshim është paraqitur një material ankues prej 55 faqesh të mbështetur në 36 prova. Duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjithë ato shkelje ligjore që kanë ndodhur në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, të cilat në vlerësimin tonë përmbushin kriteret e kërkuara nga neni 160 dhe neni 161 i Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlershmërisë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këtë qark. Ne kemi parashtuar përpara këtij Komisioni se shtetasi Taulant Balla me detyrë sekretar i përgjithshëm i Partis Socialiste, Sajmir Hasalla kandidat për deputet i Partis Socilaiste, Besian Ajazi kandidat për deputet i Partis Socialiste, Desantila Tahiraj



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

drejtore e Spitalit Rajonal Elbasan, Gjergj Luca pronar i Kompleksit Rozafa në bashkpunim me shtetas të tjerë drejtues lokal të institucioneve qendrore apo vendore, përfaqësues të Partis Socialiste apo individ të skeduar për rekordet e tyre kriminale. Si rasti i shtetasit Klement Xhaferri, Suel Çela, Marsel Rroka, Gëzim Rusi, Erald Metaj, Ernest Skilja apo Mehmet Grecaj kishin ngritur një struktur kriminale të blerjes së votave nëpërmjet parave, ndihmave ushqimore, kuponave të kartave të identitetit, dhënies së përfitimeve të tjera, por edhe nëpërmjet kërcënimeve, presioneve të ndryshme. Ndaj këtyre shtetasve ne kemi paraqitur në cilësinë e provës edhe kallëzimet penale që janë bërë nga Partia Demokratike përkatësisht në datën 23 Shkurt 2021 dhe 07 Prill 2021. Këta shtetas janë kallëzuar nga ana e Partis Demokratike për vepra penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje, përdorimin e funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, shpërdorimin e detyrës, marrjen ose përdorimin e paligjshëm të dokumentit të identifikimit, krahas blerjes së votave përkundrajt të hollave që shkojnë në shumën nga 100 deri në 300 euro. Ne kemi parashtruar përpara këtij Komisioni se me qëllim manipulimin e vullnetit të zgjedhësve u shpërndan ndihma ushqimore për familjet në nevoj apo përfitime të tjera. Siç është në fakt rasti i dyfishimit të ndihmës ekonomike nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisi Socialiste, Taulant Balla. Ndërsa Qeveria dhe partitë e Qarkut Elbasan nxorrën një sërë vendimesh të cilat sillnin përfitime për kategori të caktuara shoqërore në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor që ndalon nxjerrjen e akteve ligjore apo nënligjore që sjellin përfitime për kategori të caktuara shoqërore në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve. Sigurisht që prova që ne kemi pasur mundësi t'iu vëmë në dispozicion ishin të mjaftueshme për një sërë pretendimesh që ne kemi ngritur, por gjithsesi ato kërkoheshin të mbështeteshin edhe nga prova të tjera, të cilat duhet të merreshin nga organet e Administratës Publike. Kjo është






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

arsyeja që nga ana e Partis Demokratike Aleancës Për Ndryshim në mënyrë të përsëritur është kërkuar që të administrohen prova, informacione dhe dokumente zyrtare nga organet e Administratës Publike kërkesë e cila në vlerësimin tonë ishte plotësisht në përputhje me nenin 137 të Kodit Zgjedhor. Këto kërkesa besoj se të gjithë kemi këtu dijeni, por siç edhe publiku ka pasur mundësi të njihet janë refuzuar në mënyrë të përsëritur nga ana e këtij Komisioni. Ne kemi parashtruar përpara këtij Komisioni se Shteti vendosi në dispozicion të Partis Socialiste, tendera, konçesione, PPP dhe çdolloj privilegji publik. Kjo shkelje flagrante e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 të vendimit nr. 9, 2020 të Komisionit Rregullator u përsërit në 781 raste në të gjithë vendin. Ndër të cilat ne kemi pasur mundësinë të evidentojmë 20 raste në Qarkun e Elbasanit ku drejtuesi politik i Partis Socialiste Taulant Balla, Besian Ajazi kandidat për deputet, kryetarët e bashkive Elbasan, Cërrik edhe Gramsh shfaqen publikisht duke promovuar investime publike për qëllime të pastra elektorale. Ne kemi parashtruar në mënyrë të përsëritur përpara këtij Komisioni se në vitin para zgjedhor 2020 u prokuruan 878 kontrata publike në vlerën 505 milion euro ose 500% ë shumë se mesatarja e 5 viteve të fundit. Ne treguam përpara këtij Komisioni se shtetas me rekorde kriminale përfituan nëpërmjet kompanive të tyre tendera dhe kontrata publike nga institucionet me vlera në miliona euro. Ndërkoh që nëse do të verifikoheshin dokumentacioni i realizimit të këtyre procedurave do të vëreheshin shkelje të rënda të ligjit për prokurimet publike. Sigurisht që për ne qëllimi është shumë i qartë personat me rekorde kriminale krijuan kompani të ndryshme të cilat nuk kanë asnjëlloj aktiviteti tjetër përveçse përfitimin e tenderave apo kontratave publike dhe më pas një pjesë të këtyre parave i vendosin në dispozicion të fushatës së Partis Socialiste dhe kandidatëve të saj qoftë kjo nëpërmjet të blerjes së votave qoftë kjo nëpërmjet dhënies së ndihmave ushqimore apo për nevoja të tjera logjistike që mund të ketë



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

një parti politike. Në fakt pavarësisht se paratë qarkullojnë nga buxheti i Shtetit tek kompanitë e kriminelëve dhe pastaj të kandidatëve. Është e qartë se fushata e Partis Socialiste ishte thujse tërësisht e financuar nga para të siguruar nga buxheti i Shtetit në mënyrë krejtësisht të paligjshme. Sigurisht që ne kemi paraqitur çdo lloj prove që kemi pasur në dispozicion çdo e dhënë çdo dokument dhe çdo informacion. Pra, plot 36 prova megjithatë për ta vërtetuar deri në fund pretendimin tonë ne kishim nevojë që të merrnim edhe prova të tjera pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike për të kuptuar se sa ka qenë numri i tenderave, konçesioneve, prokurimeve apo PPP-ve të shpallura rishtazi apo për të cilat tashmë janë shpallur fituesit. Kjo kërkesë u refuzua në mënyrë të përsëritur duke refuzuar të drejtën për transparencë se si paratë e taksapaguesve shqiptarë janë vendosur në funksion të Partis Socialiste në Qarkun e Elbasanit. Ne në fakt kemi parashtruar përpara këtij Komisioni faktin se punonjësit e Administratës Shtetërore në Elbasan, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin u kërcënuan në mënyrë të përsëritur për ta vendosur të gjithë aktivitetin e tyre në funksion të fushatës elektorale të Partis Socialiste qoftë kjo nëpërmjet sjelljes së listave me emra votuesish qoftë kjo në marrjen e kartave të identitetit apo të dhënave personale qoftë përfshirja e drejtëpërdrejtë në fushatën derë më derë në favor të këtij subjekti politik. Ne parashtruam se pati rritje të jashtzakonshme të Administratës Shtetërore qoftë kjo në nivel qendror apo vendor. Rastet e identifikuar nga ana jonë janë të paktën 13 mijë, të cilat sigurisht kishin qëllime të pastra elektorale pasi Kodi Zgjedhor në nenin 91 pika 3 është e qartë se ndalohet marrja në punë ose punësimin në Administratën Publike i personave përveçse kur kjo diktohet nga nevojat e ngutshme. Institucionet publike deri më sot që ne flasim nuk kanë mundur të shpjegojnë asnjëherë që është kërkuar nga ana e tyre cilat kanë qenë nevojat e ngutshme që kanë diktuar punësimin e mijëra personave në vetëm 4 muaj. Krahas



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

sigurisht provave që ne kemi patur mundësi t'iu vendosim në dispozicion ne kërkua nga ana juaj që të merrni në cilësinë e provës informacione apo dokumente zyrtare sa i përket numrit të të punësuarëve në periudhën Janar – Prill 2021 pranë departamentit të Administratës Publike, bashkive, 244 shoqërive aksionare në pronësi të shtetit, agjensive të varësisë së Ministrive apo shoqëri që ndodhen në pronësi të bashkive për numrin e të punësuarëve qofshin këta me kontrata të përhershme apo me kontrata pune të përkohëshme. Ne sigurisht kemi pasur mundësinë të parashtrojmë faktin përpara këtij Komisioni se pati mijëra familje që u përfshinë në skemën e ndihmës ekonomike apo që masa e kësaj ndihme ndryshoj në fakt është fakt publik që nga të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financës rezulton se janë paguar rreth 2.6 milion euro më shumë ndihma ekonomike në periudhën Janar – Prill 2021 si e njëjta periudh e viti të mëparshëm. Ne parashtuam përpara këtij Komisioni se lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit u përdorën masivisht nga Partia Socialiste për vota dhe mbështetje për të dhe kandidatët e saj. Kemi pasur mundësi të tregojmë me të gjitha faktet dhe provat që ne kemi patur në dispozicion se si zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste shfaqeshin në aktivitete publike duke shpërndarë leje legalizimi në favor të familjeve të ndryshme në këmbim të votës. Sigurisht që provat të cilat ne kishim në dispozicion ishin të mjaftueshme për të filluar hetimin administrativ, por një hetim i plot dhe i gjithanshëm siç kërkohet nga parimet e procesit të rregullt ligjor do të kërkonte që nga ana e këtij Komisioni të administroheshin prova shtesë qofshin këto pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, këshillave bashkiak të vendit, Agjencisë Shtetërore të Kodastrës për numrin e lejeve të ndërtimit dhe numrin e lejeve të legalizimit të dhëna në periudhën Janar – Prill 2021. Sigurisht që ne kemi pasur mundësi të sigurojmë nga burime publike një të dhënë sipas të cilës të paktën në periudhën Janar – Mars 2021 janë dhënë rreth 10 mijë e 3 leje legalizimi, por për ta



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

provuar qark pas qarku se sa kanë qenë përmasat reale të këtij fenomeni sigurisht që ishte e nevojshme që ky Komision të vepronte sipas kërkesës që ne bëmë në përputhje me nenin 137 të Kodit Zgjedhor. Kemi pasur mundësi të relatojmë përgjatë të gjithë këtyre ditëve dhe mendoj që tashmë nuk ka ngelur njeri kush në këtë Komision as në Republikën e Shqipërisë pa e pasur krejtësisht të qartë se si të dhënat personale të qytetarëve u vodhën dhe u përdorën në mënyrë të paligjshme. Se si 500 mijë shtetas shqiptarë i'u ndalua e drejta për të votuar, se si falë një vendimi krejtësisht në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikës 27 të Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit Venecias patëm një fletë votimi që konfuzojë qytetarët e për rrjedhoj vetëm në Qarkun Elbasan pati mbi 9771 fletë votimi të pavlefshme, të cilat sigurisht do të kishin patur një impakt të konsiderueshëm në rezultatin përfundimtarë të zgjedhjeve. Kemi pasur mundësinë përgjatë të gjithë këtij procesi të parashtojmë fakte konkrete sa i përket votimit të shumëfishtë, votimit familjarë apo votimit për të tretët në fakt është fakt publik se edhe nga të dhënat të marra nga pajisjet PEI, të cilat fatëmirësisht u siguruan me kërkesën e 2 prej anëtarëve të këtij Komisioni flasin vetë. Shenjat e gishtërinjëve të 47 personave në Qarkun Elbasan janë përdorur për identifikimin e 312 zgjedhsve çka do të thot që potencialisht ka një dyshim të arsyeshëm se 47 persona kanë votuar 312 herë ose 7 herë për person. Ky sigurisht është një fakt publik dhe juridik, i cili duhet verifikuar dhe hetuar deri në fund nga ana e Prokurorisë. Por për sa i vlen këtij procesi ajo përbënë një parregullsi që ka cënuar procesin zgjedhor të 25 Prillit në Qarkun Elbasan. Për ne është e qartë se zgjedhjet e 25 Prillit në Qarkun e Elbasanti ishin një masakër elektorale që u shoqëruan ose u evidentuan për raste flagrante të shit – blerjes së votës nga drejtues të Partis Socialiste në bashkpunim me individ me rekorde të tmerrshme kriminale. U shoqëruan me shkrirjen e Shtetit dhe partis në një të vetme, u shoqëruan me



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

vjedhjen dhe përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale, mohimin e të drejtës së emigratnëve për të votuar, pavlefshmërinë e vullnetit të mbi 9700 zgjedhsve në Qarkun Elbasan apo 83000 zgjedhsve në të gjithë Shqipërinë si dhe me raste flagrante të votimit të dyfishtë. Nga ana e Partisë Demokratike dhe Alenacës për Ndryshim në përputhje me detyrimin që ka ky subjekt zgjedhor përpara të gjithë zgjedhsve të saj dhe të gjithë shqiptarëve që në datën 25 Prill vendosën të mbështesin ndryshimin dhe opozitën e bashkuar ne paraqitëm përpara jush një material të detajuar dhe voluminuz shpjegues prej 55 faqesh të mbështetur në të gjitha provat që kishim ne në dispozicion dhe disponim, në numër 36 duke kërkuar po ashtu nga ana e këtij Komisioni në mënyrë të përsëritur që të bëjë transparencë për të zbardhur të plot se çfarë kishte ndodhur në zgjedhjet e 25 Prillit. Kërkesat tona tashmë janë refuzuar plot 9 herë dhe janë refuzuar rreth 171 kërkesa për të bërë transparencë për të gjithë zgjedhsit shqiptarë kudo që ata janë. Sigurisht ne nga ana jonë për sa na takon besojmë që e kemi bërë detyrën që na kanë ngarkuar qytetarët shqiptarë qofshin ata 730 mijë që votuan opozitën e bashkuar në të gjithë Shqipërinë qofshin 66 mijë zgjedhës në Qarkun Elbasan dhe kjo nuk është vetëm se fillimi pasi sigurisht cilido qoftë vendimi që nga ana e këtij Komisioni ne sigurisht që do ta vazhdojmë deri në fund këtë betej. Sepse besojmë fortë që nuk është një betej që bëhet për ne që jemi këtu në këtë sallë apo që bëhet për palët ankuese apo partit politike, por është një betej që sigurisht bëhet për qytetarët shqiptar, të cilët besojmë që janë viktimat e vërteta të 25 Prillit. Bazua në sa më sipër dhe gjithçka ne kemi pasur mundësi të parashtojmë të relatojmë dhe të sjellim përpara këtij Komisioni gjithçka që ky Komision ka pasur mundësi të konstatoj nga ana e tij. Përfundimisht kërkojmë që nga ana e këtij Komisioni të shpallen të pavlefshme zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 për zonën zgjedhor Qarku



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.05.2021*

Elbasan dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në një periudhë sa më të afërt, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Logu. Ju lutem përfaqësuesi..

**Z. M. Legisi, përfaqësues i PS-së:** Po, faleminderit i nderuar në kërkojmë rrëzimin e kërkesës të pabazuar në ligj dhe prova në bazë të nenit 30 të vendimit nr. 3, 2020 të Komisionit Rregullator. Për të mos rënë në përsëritje të parashtimit që kemi bërë gjatë hetimit administrativ kërkesa mbetet pa provuar në referencë në lidhje me një qendër specifike apo disa qendra votimi. Pasi të gjitha ngjarjet që pretendohen sikur të kenë ndodhur nuk kanë ndodhur aspak në qendrat e votimit, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Faleminderit i nderuar, për sa i përket subjektit Lëvizja Socialiste Për Integrim në i qëndrojmë konkluzioneve të dala nga Partia Demokratike.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, atëherë KAS do të tërhiqet për vendim. Shpalljen e këtij vendimi do ta bëjmë ditën e hënë, në datën 31.05.2021 ora 10:00. Tani vazhdojmë me Qarkun Korçë që relator është kolegu Çefa.

**Z. E. Çefa:** Atëherë, për shkak të nevojës të njërit nga subjekteve ankuese për të koordinuar lidhur me mënyrën e përfaqësimit do të bëjmë 10 minuta pushim. Do të rifillojmë pastaj për të njoftuar nëse mund ta bëjmë sot vijim e seancës për shqyrtimin e kërkesave ankimore për Qarkun Korçë apo edhe kjo seancë do të duhet të shtyhet për ditën e hënë.

